

**SUPREME COURT OF KOSOVO
GJYKATA SUPREME E KOSOVËS
VRHOVNI SUD KOSOVA**

**KOSOVO PROPERTY AGENCY (KPA) APPEALS PANEL
KOLEGJI I APELIT TË AKP-së
ŽALBENO VEĆE KAI**

GSK-KPA-A-222/2014

Prishtinë,

10 gusht 2016

Në çështjen juridike të:
N. S.

Pala ankuese

Përfaqësuese: B. R. Z.
Avokate

Kolegji i Apelit të AKP-së i Gjykatës Supreme të Kosovës, i përbërë nga Sylejman Nuredini, kryetar i kolegjit, Rolandus Bruin dhe Beshir Islami, gjyqtar, duke vendosur mbi ankesën e paraqitur kundër vendimit të Komisionit për Kërkesa Pronësore të Kosovës (tani e tutje: KKPK) nr. KPCC/D/A/220/2013 të datës 27 nëntor 2013 (lënda e regjistruar në Agjencinë Kosovare të Pronës me numër KPA52588), tani e tutje vendimi i KKPK-së, pas shqyrtimit të mbajtur më 10 gusht 2016, mori këtë:

AKTGJYKIM

Ankesa e paraqitur nga N. S. kundër vendimit të Komisionit për Kërkesa Pronësore të Kosovës nr. KPCC/D/A/220/2013, të datës 27 nëntor 2013, sa i përket kërkesës me numër KPA52588, hedhet poshtë si e paafatshme.

Përmbledhja e çështjeve procedurale dhe faktike

1. Më 31 janar 2008, N. S.(tani e tutje: pala ankuese) ka paraqitur kërkesë pranë Agjencisë Kosovare të Pronës (tani e tutje: AKP), duke kërkuar konfirmimin e të drejtës pronësore mbi ngastrën kadastrale në Pidiç, zona kadastrale Gjilan, ngastra me numër 469/3, e regjistruar në fletën poseduese nr. 97 CM Pidiç/183 Vladovo, si mal në vendin e quajtur ‘Kodra Madle’ (tani e tutje: prona e kërkuar). Ai thekson se babai i tij i ndjerë Z. S. është bartës i së drejtës pronësore të pronës së kërkuar dhe se prona ishte humbur si rezultat i rrethanave të viteve 1998/1999. Ai përmend 12 qershorin 1999, si datë të humbjes së pronës.
2. Pala ankese në mes tjerash i ka dorëzuar AKP-së dokumentet në vijim:
 - Certifikatën e lindjes, të lëshuar nga Komuna e Gjilanit, të datës 15 qershor 2007, nr. 200-2007-V; sipas kësaj certifikate Z. S. është babai i palës ankuese;
 - Certifikatën e vdekjes, të lëshuar nga Komuna e Smedervës, Serbi; sipas kësaj certifikate Z. S. ka vdekur më 23 maj 2007 (tani e tutje: certifikata e vdekjes);
 - Aktgjykimin e Gjykatës së Qarkut të Gjilanit të datës 21 prill 1982, nr. 198/80; me anë të këtij aktgjykimi është pranuar kërkesa e Z. S. dhe në mes tjerash pala përgjegjëse në kërkesë është obliguar që t’ia njoh pronësinë Z. S. mbi disa prona të paluajtshme; njëra nga këto prona është ngastra e klasës ‘mal’ në vendin e quajtur ‘Kodra Madle’, ngastra nr. 439/3 e regjistruar në fletën poseduese nr. 97, 97 CM Pidiç/183 Vladovo (tani e tutje: aktgjykimi i vitit 1982);
 - Fletën poseduese nr. 97, nga Drejtoria e Gjeodezisë e Komunës së Gjilanit, zona kadastrale Pidiç, e datës 5 tetor 1977; në këtë listë Z. S. është regjistruar si pronarë i ngastrës ‘294 469/3’, e klasës ‘mal, dhe me sipërfaqe prej 2.00.00 ha; emri i vendit është i palexueshëm;

- Kontratën e shitblerjes të datës 26 gusht 1961, të vërtetuar pranë Gjykatës së Qarkut në Gjiilan më 6 nëntor 1961, me numër 909; sipas kësaj kontrate Z. S. ka blerë ngastrën e malit në vendin e quajtur ‘Kodra Malle’, ngastra nr. ‘29/1/469’, me sipërfaqe prej 2.00.00 ha (tani e tutje kontrata e shitblerjes e vitit 1961).
3. AKP-ja ka bërë njoftimin e kërkesës, mirëpo asnjë palë tjetër nuk ka marrë pjesë në procedurën pranë KKPK-së.
 4. Sipas raporteve të verifikimit të datës 24 prill 2009 dhe 3 dhjetor 2012, AKP-ja ka gjetur se ngastra e (nën-ndarë) 469/3 nuk ekziston, por vetëm ngastra e pandarë me numër 469. Sipas librave të vjetër, është vërejtur se ngastra ka pësuar disa ndryshime mirëpo shënimet mungojnë ose gjenden në Krushevc. AKP-ja sipas detyrës zyrtare ka futur në dosje dy certifikata mbi të drejtat e paluajtshme të datës 23 prill 2009 dhe 9 nëntor 2012, të lëshuara nga zyra kadastrale në Gjiilan që i referohen njësisë kadastrale P-70403049-00469-0. Sipas këtyre certifikatave, ngastra nr. 469, me sipërfaqe prej 11,148 m², e klasës mal, në vendin e quajtur ‘Kodra Mola’ është regjistruar në emër të D. H. Sipas shënimit në dorëshkrim në certifikata, ky regjistrim është azhurnuar më 1990.
Sipas raportit të konsoliduar të verifikimit të datës 31 tetor 2013, AKP-ja ka verifikuar pozitivisht certifikatën e vdekjes dhe aktgjykimin e vitit 1982. AKP-ja nuk e ka verifikuar kontratën e shitblerjes të vitit 1961 sepse ajo i referohet një ngastre me numër 29/1/469 dhe ka sipërfaqe prej 2.00.00 ha.
 5. KKPK-ja në vendimin e saj ka refuzuar kërkesën. Në arsyetimin tij (paragrafët 12, 167 dhe 168), aq sa është relevante, KKPK-ja i referohet aktgjykimin të vitit 1982 dhe thekson se dokumentet e tjera të paraqitura nga pala ankuese nuk janë relevante. KKPK-ja më tutje thekson se AKP-ja ka marrë certifikatën mbi të drejtat e paluajtshme në të cilën ngastra e pandarë nr. 469 figuron në emër të D. H. KKPK-ja përfundon se pala ankuese ka dështuar që të dëshmojë të drejtat pronësore mbi pronën e kërkuar.
 6. Vendimi i është dorëzuar palës ankuese më 18 qershor 2014.
 7. Pala ankuese ka paraqitur ankesë kundër vendimit të KKPK-së. Shkresa e ankesës mban datën 15 korrik 2014. AKP-ja e ka pranuar atë (përmes zyrës së pronës të UNHCR-së) më 21 korrik 2014.

Pretendimet e palëve

8. Pala ankuuese pohon se e ka paraqitur ankesën me kohë. Ai pretendon se babai i tij e ka fituar pronësinë mbi pronën e kërkuar në bazë të kontratës së shitblerjes të vitit 1961. Prandaj, vendimi i KKPK-së është bazuar në vërtetim të gabuar apo jo të plotë të gjendjes faktike.

Arsyetimi ligjor*Pranueshmëria e ankesës*

9. Sipas nenit 12.1 të Rregullores së UNMIK-ut 2006/50 mbi zgjidhjen e kërkesave lidhur me pronën e paluajtshme private, duke përfshirë pronën bujqësore dhe atë komerciale, siç është ndryshuar me Ligjin nr.03/L-079 (tani e tutje: Ligji nr.03/L-079) brenda tridhjetë (30) ditëve nga njoftimi i palëve nga Agjencia Kosovare e Pronës për vendimin e Komisionit, pala mund të paraqesë ankesë ndaj vendimit të tillë.
10. Pasi që vendimi i KKPK-së palës ankuuese i është dorëzuar më 18 qershor 2014, afati prej 30 ditësh për paraqitjen e ankesës ka skaduar të premten më 18 korrik 2014.
11. Shkresa e ankesës mban datën 15 korrik 2014, mirëpo ajo është pranuar nga AKP-ja të hënën më 21 korrik 2014. Që i bie është pas afatit prej 30 ditësh.
12. Në shkresë është shkruar se është “dërguar përmes postës së rregullt në zyrën e UNHCR-së për çështje pronësore në Beograd”.
13. Në dosje nuk ka asnjë provë se pala ankuuese ka paraqitur ankesën përmes postës, siç është shkruar në shkresën e ankesës më 15 korrik 2014. Por, nëse pala ankuuese në fakt e ka dorëzuar shkresën e ankesës në atë datë apo më 16 ose 17 korrik 2014 në postë, kjo nuk do shpinte në përfundim se ai e ka paraqitur ankesën brenda afatit kohor.
14. Sipas nenit 127.2 të Ligjit mbi procedurën kontestimore, që është i zbatueshëm në këtë procedurë sipas nenit 12.2 të Ligjit nr.03/L-079, data e dorëzimit të shkresës së ankesës në postë do të konsiderohet si data e paraqitjes së ankesës vetëm për postën e regjistruar dhe telegramet por jo edhe për postën e paregjistruar siç pretendon pala ankuuese se ka vepruar në këtë rast.

Përfundim

15. Pala ankuuese ka paraqitur ankesën pas afatit prej 30 ditësh. Prandaj, ankesa është e paafatshme. Rrjedhimisht, sipas nenit 13.3 b të Ligjit nr.03/L-079, Gjykata Supreme ka vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Këshillë juridike

16. Në pajtim me nenin 13.6 të Ligjit nr.03/L-079, ky aktgjykim është i formës së prerë dhe nuk mund të kundërshtohet përmes mjeteve të zakonshme apo të jashtëzakonshme juridike

Sylejman Nuredini, Kryetar i kolegjit

Rolandus Bruin, Gjyqtar i EULEX-it

Beshir Islami, Gjyqtar

Nënshkruar nga: Sandra Gudaityte, Referente e EULEX-it